



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE  
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 13828/3 /prot.

Lezhë, më: 20/2 .2024

PROJEKT-V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_, Datë 20/2, 2024

PËR

**DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFAQES SË FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË PARASHIKUARA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR PYJET.**

Bazuar në Ligjin nr.139 datë 17.12.2015" Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", VKM-në nr. 433 datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM-në nr 684 datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave e Bashkive", VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i ndryshuar, në udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, date 9.06.2016 "Për rregullat, proçedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", në udhëzimin nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Përmbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar", bazuar në kërkesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme për marrje toke pyjore në përdorim, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e proçedurave të dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **16 ha**, nga e cila (**1.77 ha** sheshet e Aerogjeneratoreve + **7.34 ha** sipërfaqe ndihmëse që shtrihet nën helikat e aerogjeneratorit + **5.1 ha** sipërfaqe e rrugës e barabartë me **10.2 km** gjatësi + **1.79 ha** për linjën elektrike e barabartë me **3.57 km** gjatësi) mund të jepen në përdorim dhe shtrihet në ngastrat/nëngastrat: **55a, 54, 53a, 53b, 64a, 65a, 65b, 111, 66, 67, 109a, 109b, 108, 107, 106, 105a, 103a, 101, 100, 99a, 108, 110a, 116, 144, 141** brenda Ekonomisë Pyjore "Molung" e shtrirë në Njësitë Administrative Kolsh dhe Zejmen, sipas Raportit Teknik, bashkangjitur.

2. Afati për dhënien në përdorim do të jetë 10 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Vlera fillestare e qirasë në vit, përfshirë edhe infrastrukturën ndihmëse do të jetë **2527080 (Dy milion e pesëqind e njëzet e shtatë mijë e tetëdhjet)**, lek e detajuar sipas zërave.
  - Sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim, **9.11 ha** në kategorinë e përdorimit të territorit Shkurre **X 176000 lek/ha = 1603360 lek.**
  - Sipërfaqe rruge auto për tu dhënë në përdorim, **9.47 km** në kategorinë përdorimit të territorit Shkurre **X 35000 lek/km = 331450 lek.**
  - Sipërfaqe rruge auto për tu dhënë në përdorim, **0.71 km** në kategorinë përdorimit të territorit Cungishte **X 50000 lek/km = 35500 lek.**
  - Sipërfaqe linje elektrike për tu dhënë në përdorim, **2.35 km** në kategorinë përdorimit të territorit Shkurre **X 145000 lek/km = 340750 lek.**
  - Sipërfaqe linje elektrike për tu dhënë në përdorim, **1.22 km** në kategorinë përdorimit të territorit Cungishte **X 145000 lek/km = 176900 lek.**
  - Vlera e materialit drusor që pritet nga hapja e rugëve dhe linjës elektrike, dru zjarri **65 m3 X 600 lek/m3 = 39120 lek.**
4. Të kryejë rehabilitim mjedisor sipas planit të rehabilitimit dhe VNM-së përfundimtare.
5. Proçedura për dhënien në përdorim do të zhvillohet me garë të hapur sipas akteve ligjore e nën ligjore në fuqi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Lezhë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

**KRYETARI**

**Pjerin NDREU**

**Drejtoria e Bujqësisë**

Drejtori: E Smaçi

Përgjegjës: A Palushi

Kopje Nr. 3

